



Asociacioni i Komunave të Kosovës

**R R E G U L L O R J A
E P U N Ë S**

**KOLEGJIMI I DREJTORËVE TË ADMINISTRATËS
TË KOMUNAVE TË KOSOVËS**

2011

Me qëllim të realizimit të Kërkesave të Kolegjiumit të Administratës të Komunave të Kosovës, përkrahur nga **Asociacioni i Komunave të Kosovës** me seli në Prishtinë, kolegjiu në mbledhjen e mbajtur më 10 maj 2011 miratoi :

RREGULLOREN E PUNËSË

KOLEGJIUMIT TË ADMINISTRATËS TË KOMUNAVE TË KOSOVËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSME

Qëllimi

Neni 1

- a. Me këtë rregullore përcaktohet organizimi dhe mënyra e punës së Kolegjiumit të Administratës të Komunave të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kolegjiumi);

1.2 Çështjet dhe kërkesat me rëndësi nga fushëveprimi i Kolegjiumit shqyrtohen në Kolegjium. Kolegjiumi jep mendime dhe propozime veçanërisht për:

- a) ndihma profesionale që do t'i bëhet kryetarit, Kuvendit dhe mekanizmave ndihmëse (komiteteve) lidhur me procesin e marrjes së vendimeve;
- b) ndihma në zbatimin e ligjeve, urdhëresave, instruksioneve, vendimeve që kanë të bëjnë me punën e drejtorive komunale, Kolegjiumeve apo Asociacionit të Komunave të Kosovës, nëse nuk është paraparë ndryshe;
- c) ndihmën, apo dhënien e kontributit nëpër Grupe Punuese për hartim të legjislacionit, apo shërbimeve tjera varësisht prej nevojave të Kolegjiumit, Komunës apo të Asociacionit të Komunave të Kosovës;
- d) bashkëpunimin me Kolegjiumet tjera, Komunitat, institucionet e Republikës së Kosovës
- dh) bashkëpunimin me partneret vendor e ndërkombëtar, të Kolegjiumeve, Komunave, Asociacionit të Komunave të Kosovës-së etj;

II. PËRBËRJA E KOLEGJIUMIT

Neni 2

2.1 Kolegjiumin e përbëjnë drejtorët e Administratës së Komunave të Kosovës, të caktuar me kontratë apo të emëruar nga Kryetari i Komunës;

2.2 Mandati i anëtarit të Kolegjiumit do të varet nga kohëzgjatja e kontratës të tij;

2.3 Kolegjiumi ka kryesinë e punës të përbërë prej 7 (shtatë) anëtarëve;

2.4 Kryesia e Kolegjiumit do të zgjedhet nga vet anëtarët e Kolegjiumit me shumicë të thjeshtë votash. Votimi do të jetë i hapur.

2.5 Kryesin e punës së Kolegjiumit e udhëheq kryesuesi e në mungesë të tij edhe zëvendëskryesuesi;

2.6 Kolegjiumi takohet çdo 2(dy) muaj dhe brenda vitit duhet t'i mbajë më së shumti 6(gjashtë) takime ;

III. PËRGATITJA DHE THIRRJA E MBLEDHJEVE TË KOLEGJIUMIT

Neni 3

- 3.1 Puna e Kolegjiunit realizohet nëpërmjet takimeve, të cilat thirren dhe mbahen sipas planit të përgatitur nga Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe i miratuar nga ana e Kolegjiunit;
- 3.2 Kryesuesi i Kolegjiunit apo zëvendëskryesuesi fton anëtarët e kolegjiunit, duke bërë të ditur temën e diskutimit së paku 5 (pesë) ditë para se të mbahet mbledhja;
- 3.3 Kolegjiuni përmban kuorum nëse më shumë se gjysma e anëtarëve marrin pjesë në mbledhje;
- 3.4 Rekomandimet dalin me shumicë të votave ;

IV. UDHËHEQJA E PUNËS DHE VENDOSJA NË MBLEDHJE

Neni 4

- 4.1 Mbledhjet e Kolegjiunit sipas kësaj rregulloreje i udhëheq kryesuesi ose në mungesë të tij zëvendëskryesuesi apo njëri nga anëtarët e kryesisë së Kolegjiunit;
- 4.2 Para fillimit të mbledhjes, vërtetohet kuorumi i mjaftueshëm i anëtarëve, pastaj procedohet me rendin e ditës;

Neni 5

- 5.1 Kryesuesi i Kolegjiunit, hap mbledhjen dhe njofton anëtarët se a pajtohen me rendin e ditës të propozuar. Pas miratimit të rendit të ditës, fillon mbledhja sipas pikave të rendit të ditës;
- 5.2 Pika për rendin e ditës mund të propozojnë edhe anëtarët e Kolegjiunit;

Neni 6

- 6.1 Anëtarët e Kolegjiunit marrin pjesë në diskutim për të gjitha pikat e rendit të ditës, kërkojnë shpjegime, shtrojnë pyetje dhe kërkojnë përgjigje nga referuesit;

Neni 7

- 7.1 Shqyrtimi i pikave të rendit të ditës udhëhiqet veç e veç , sipas rregullit së pari në parim e pastaj në veçanti;
- 7.2 Mënyrën e udhëheqjes së shqyrtimit e propozon kryesuesi. Kryesuesi mund të propozojë që koha e shqyrtimit të zgjatë p.sh. 5(pesë) minuta dhe për replikë edhe 1 (një) minutë;

Neni 8

- 8.1 Askush nuk mund ta marrë fjalën në diskutim para se t'ia japë fjalën kryesuesi, të ndërhyjë në fjalë pjesëmarrësit në diskutim, apo në ndonjë mënyrë të pengojë punën e mbledhjes;
- 8.2 Kryesuesi ka të drejtë që anëtarit, i cili e pengon punën normale të mbledhjes, t'i japë vërejte, t'ia marrë fjalën e në rast të prishjes së rendit të ditës ta largojë edhe nga mbledhja;

Neni 9

- 9.1 Diskutimi sipas pikave të veçanta të rendit të ditës zgjatë sipas rregullës deri sa të mbarojnë diskutimet e të gjithë të paraqitura;
- 9.2 Kryesuesi mbyll diskutimin dhe propozon që të kalohet në përmbledhje të diskutimit;
- 9.3 Në bazë të propozimeve në material, mendimeve të paraqitura gjatë diskutimeve, kryesuesi formulon rezymetë apo rekomandimet dhe të njëjtat i paraqet për votim;

Neni 10

10.1 Mbi propozimet e vendimeve vendoset me votim të hapur, i cili bëhet me ngritjen e dorës, ndërsa rezultatet e votimit vërtetohen me numërim;

10.2 Vendimi konsiderohet i aprovuar, nëse për atë deklarohen me shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm;

V. PROCESVERBALI

Neni 11

11.1 Për punën e Kolegjiut, në mbledhje mbahet procesverbali;

11.2 Procesverbalin sipas rregullës e udhëheq anëtari të cilin e cakton kryetari në fillim të mbledhjes ose Koordinatori i Kolegjiumeve të Asociacionit të Komunave të Kosovës .

11.3 Procesverbali mbi punën e kolegjiumit përmban të dhënat themelore, dhe atë: ditën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, shenjën dhe numrin e mbledhjes, numrin e anëtarëve prezent të Kolegjiumit, personat e tjerë që janë të pranishëm, emrin e kryesuesit dhe emrin e procesmbajtësit, rendin e përcaktuar të ditës, emrat e atyre që diskutojnë me përmbajtje të shkurtër të diskutimit dhe rezultatet e votimit sipas pikave të veçanta të rendit të ditës , mendimet e ndara të anëtarëve të Kolegjiumit dhe çështjet tjera me rëndësi.

11.4 Në fund të çdo pike të rendit të ditës shënohet përfundimi sipas rendit të formulimit, ashtu si e paraqet kryesuesi;

11.5 Procesverbali mbahet në origjinal dhe nga një kopje e ekstraktit iu dërgohet pjesëmarrësve në mbledhje;

11.6 Procesverbali origjinal nënshkruhet nga kryetari dhe nga procesmbajtësi dhe i njëjti ruhet me materialin tjetër të mbledhjes dhe ruhet në arkiv, i cili pastaj si raport publikohet në ueb faqen e Asociacionit të Komunave të Kosovës;

VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 12

12. Çështjet që nuk janë rregulluar me këtë rregullore, rregullohen me vendime të veçanta të kolegjiumit;

Neni 13

13. Kolegjiumi mund të iniciojë ndryshimin apo plotësimin e kësaj Rregullore me shumicën e votave të anëtarëve të tij, pra me mënyrën e njëjtë edhe të aprovimit të saj. Kërkesën për iniciim për ndryshimin apo plotësimin e kësaj Rregulloreje mund ta bëjnë së paku gjysma e anëtarëve të Kolegjiumit.

Neni 14

14. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregullorja e kaluar e datës _____;

Neni 15

15. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit dhe zbatohet nga dita e miratimit të saj;

KRYESUESI I KOLEGJIUMIT
